



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/1048

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahim-Paneliste Individuale duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) SRAHEP SH.P.K., kundër Mosekzekutimi i vendimit të OSHP-së të KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me inventar në Qendrat e Ndryshme Sociale -Ritender me numër të prokurimit 616-25-6793-1-2-1, me 19.12.2025, mori:

Vendim

1. Refuzohet si e pa bazuar ankesa e SRAHEP SH.P.K., me nr. 2025/1048, e datës 24.10.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me inventar në Qendrat e Ndryshme Sociale - Ritender me numër të prokurimit 616-25-6793-1-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES.

2. Kjo ankesë konsiderohet si çështje e gjykuar (Res Judicata) pasi që pretendimet ankimore në këtë ankesë janë të njëjta si në Vendimin PSh. Nr. 2025/0770 i dt: 17/10/2025, ku objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, andaj ky rast konsiderohet si çështje e gjykuar “Res Judicata”.

3. I lejohet AK-Komuna e Prishtinës të vazhdoj tutje lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me inventar në Qendrat e Ndryshme Sociale -Ritender me numër të prokurimit 616-25-6793-1-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES.

4. Konfiskohen mjetet e deponuara në emër të tarifës ankimore për ankuesit. Mjetet e konfiskuara kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës ashtu sikurse parashikohet me nenin 31.5 të Rregullores së Punës së OSHP.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 25.07.2025, KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B05 Njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me Furnizim me inventar në Qendrat e Ndryshme Sociale -Ritender me numër të prokurimit 616-25-6793-1-2-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: **100,000.00 €**.

Me 21.10.2025, OE SRAHEP SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 22.10.2025, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 24.10.2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE SRAHEP SH.P.K., me nr. 2025/1048 lidhur me aktivitetin Furnizim me inventar në Qendrat e Ndryshme Sociale -Ritender me numër të prokurimit 616-25-6793-1-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues SRAHEP SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Pas shqyrtimit të Formularit BS4 dhe njoftimit të korigjuar të tenderit të lartcekur, konstatohet se Komuna e Prishtinës nuk e ka zbatuar plotësisht vendimin e OSHP-së, përkundër detyrimit ligjor të nenit 131.3 të LPP-së. Vendimi i OSHP-së urdhëronte heqjen ose korigjimin e disa kriterëve që u vlerësuan diskriminuese dhe të pajustificuara. Megjithatë, në dosjen e re të tenderit, këto kërkesa vazhdojnë të ekzistojnë pa ndryshime thelbësore.

Autoriteti kontraktues KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS ka publikuar njoftimin për kontratë me titull: Furnizim me inventar në Qendrat e Ndryshme Sociale - Ritender, me nr. të prokurimit: 616-25-6793-1-2-1 dhe me nr. të brendshëm 616-25-156-1-2-1. Pasi kemi shkarkuar njoftimin, kemi parë që Autoriteti Kontraktues ka parashtruar disa kërkesa të kualifikimit të cilat haptas favorizojnë ndonjë operator ekonomik të paracaktuar pasi që të njëjtat nuk janë në përputhje me dispozitat ligjore të legjislacionit të prokurimit sepse kërkesat nuk janë relevante me natyrën e procedurës së prokurimit në fjalë.

Gjithashtu Autoriteti Kontraktues duke pasur parasysh që çmimi i kontratës është i një vlere të mesme ka vendosur kriterë diskriminuese edhe tek pikat tjera. Në pikën nr. 2 ka kërkuar që: 2. OE ofertues duhet të caktojë një Menaxher të projektit i cili duhet të jetë dizajner i enterierit inxhinier i diplomuar ose Master - 5 vite përvojë pune pas diplomimit. 2. OE me vendim duhet të emërojë menaxherin e projektit me së paku 5 vite përvojë pune e dëshmuar me CV, diplomën

mbi kualifikimin origjinal.

Këtu Autoriteti Kontraktues ka kërkuar OE ofertues që duhet të caktojë një menaxher të projektit i cili duhet të jetë dizajner i enterierit inxhinier i diplomuar ose Master - 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Kjo kërkesë nuk ishte relevante me këtë natyrë të prokurimit pasi që për artikujt e kërkuar nga ju si A.K. i keni të specifikuar të gjitha dimensionet të cilat do punohen artikujt e kërkuar, andaj edhe nga kjo kërkesë shihet qartë se A.K. është vënë në lajthitje nga një O.E. Andaj kërkojmë që edhe kjo kërkesë në fjalë të hiqet.

Në pikën nr. 3 ka kërkuar që: 3. OE ofertues duhet të ketë një inxhinier të diplomuar të emergjencave ose master me së paku 5 vite përvojë pune pas diplomimit, i cili duhet të jetë i certifikuar si ekspert për siguri në punë dhe mbrojtje nga zjarri.

Autoriteti kontraktues ka kërkuar që OE ofertues duhet të ketë një inxhinier të diplomuar të emergjencave ose master me së paku 5 vite përvojë pune pas diplomimit, i cili duhet të jetë i certifikuar si ekspert për siguri në punë dhe mbrojtje nga zjarri. Natyrë e prokurimit ka të bëjë me Furnizim me inventar në Qendrat e Ndryshme Sociale - Ri-Tender e cila kërkesë nuk ka të bëjë fare me natyrën e prokurimit pasi që shumica e inventarit janë krejtësisht të lehta për t'u bërë transporti, bartja dhe montimi i inventarit. Në këtë natyrë të prokurimit me titull: Furnizim me inventar në Qendrat e Ndryshme Sociale - Ri-Tender nuk ka fare të bëjë me ekspertin e mbrojtjes nga zjarri pasi që bie ndesh me rregulloren e prokurimit duke kërkuar një ekspert i cili fare s'ka të bëjë me furnizim me inventar në Qendrat e Ndryshme Sociale - Ri-Tender, pra edhe tek kjo kërkesë ka kufizuar konkurrencën pasi që nuk i ka dhënë mundësi operatorëve ekonomik të cilët janë biznese të vogla që të marrin pjesë në këtë tender. Andaj konsiderojmë se kjo kërkesë është qesharake dhe kërkojmë që edhe kjo kërkesë në fjalë të hiqet.

Në pikën nr. 4. OE ofertues duhet të ketë së paku pesëmbëdhjetë (15) punëtorë tjerë ndihmës të angazhuar për këtë projekt të trajnuar për mbrojtje dhe siguri në punë, certifikatat valide dhe 5 të tjerë për mbrojtje nga zjarri, certifikatat valide. 4. Të prezantohen certifikatat valide, të bashkëngjitet lista e punëtorëve, të bashkëngjitet licenca e kompanisë që ka kryer trajnimin e punëtorëve.

Autoriteti Kontraktues tek kjo kërkesë haptas e kufizon konkurrencën pasi që ky projekt mund të realizohet edhe nga 2 punëtorë tjerë ndihmës dhe kërkesa tjetër që OE duhet t'i ketë 5 punëtorë për mbrojtje nga zjarri bie ndesh me natyrën e prokurimit pasi që natyra e prokurimit ka të bëjë me furnizim me inventar dhe jo me sigurime të objekteve, jo me testime të pajisjeve që ndezin apo fikin zjarrin, andaj shumë qartë shihet se Autoriteti kontraktues është vënë në lajthitje, andaj kërkojmë që edhe kjo kërkesë në fjalë të hiqet.

Në pikën nr. 5. OE duhet të ofrojë dëshmi nga prodhuesi (apo dileri) për ISO standarde si në vijim: ISO 10002 2018, ISO TC 136, ISO 19682 2023, ISO 10204, EN 1335-1, EN 10901 2009+A1 2011, TS EN 10204 2007, TS ISO 21524 2021. Dëshmia: kopjet e ISO certifikatave të kërkuara.

Autoriteti kontraktues ka vendosur kritere diskriminuese edhe në pikën 6 në të cilën ka kërkuar që ISO në vazhdim: ISO 10002 2018, ISO TC 136, ISO 19682 2023, ISO 10204, EN 1335-1, EN 10901 2009+A1 2011, TS EN 10204 2007, TS ISO 21524 2021. Certifikata ISO 10002 2018 ka të bëjë me menaxhimin e cilësisë - kënaqësia e klientit, si dhe TS ISO 21524 2021 ka të bëjë me testet e rezistencës ndaj zjarrit - elementet e ndërtimit të ndërtesës - kërkesat për perde aktive zjarri. Pra edhe ky kriter është diskriminues pasi që disa prej certifikatave të kërkuara nuk kanë

të bëjnë fare me këtë natyrë të prokurimit pasi që natyra e prokurimit në fjalë ka të bëjë me furnizim me inventar në Qendrat e Ndryshme Sociale - Ri-Tender dhe jo me menaxhimin e cilësisë, s'ka të bëjë as me kënaqësinë e klientit, si dhe s'ka të bëjë me testet e rezistencës ndaj zjarrit, s'ka të bëjë as me elementet e ndërtimit të ndërtesës as me kërkesat për perde aktive zjarri pasi që në projektin në fjalë ka të bëjë me prodhimin e mobiljeve apo inventarit dhe jo me ndërtimin e objekteve apo ndërtesave, si dhe kërkojmë që edhe certifikatat tjera tek kjo kërkesë siç janë: ISO TC 136, ISO 19682 2023, ISO 10204, EN 1335-1, EN 10901 2009+A1 2011, TS EN 10204 2007 të hiqen pasi që dukshëm zvogëlojnë konkurrencën dhe iu pamundësojnë kompanive të reja pjesëmarrjen në këtë tender.

Në pikën nr. 6. OE ofertues duhet të sjellë listën e pajisjeve, mjeteve, makinave teknike: 1. kamion transportues, 2. furgon transportues, 2. pikap. Lista e pajisjeve, mjeteve, makinave teknike mbi pronësinë (apo të marrjes me qira) të mjeteve, stabilimenteve, pajisjeve teknike dhe kapacitetet tjera të nevojshme për plotësimin e kërkesave (sipas specifikimit në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit). Lista pajisjeve dhe mjeteve, makinave teknike të OE duhet të jetë origjinale, e nënshkruar dhe e vulosur nga operatori ekonomik, duhet të ofrojë si dëshmi: fotografi, specifikacion teknik, librezë; për pajisjet që nuk regjistrohen të dëshmohen me dud doganor të noterizuar ose faturë.

Autoriteti Kontraktues gjithashtu ka vendosur kushte të pjesëmarrjes të cilat janë diskriminuese. Autoriteti Kontraktues ka kërkuar që OE ofertues duhet të sjellë listën e pajisjeve, mjeteve, makinave teknike: 1. kamion transportues, 2. furgon transportues, 2 pikap. Lista e pajisjeve, mjeteve, makinave teknike mbi pronësinë (apo të marrjes me qira) të mjeteve, stabilimenteve, pajisjeve teknike dhe kapaciteteve tjera të nevojshme për plotësimin e kërkesave (sipas specifikimit në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit). Lista pajisjeve dhe mjeteve, makinave teknike të OE duhet të jetë origjinale, e nënshkruar dhe e vulosur nga operatori ekonomik, duhet të ofrojë si dëshmi fotografi, specifikacion teknik, librezë; për pajisjet që nuk regjistrohen të dëshmohen me dud doganor të noterizuar ose faturë. Pra kërkesa që për pozicionet e lartcekura të paraqiten fotografi apo të dëshmohen me dud doganor të noterizuar ose faturë e kufizon në masë të madhe konkurrencën pasi që e drejton tregun për furnizim të këtyre materialeve vetëm nga një prodhues i parazgjedhur. Kjo paraqet edhe shkelje të dispozitave të nenit 7 të LPP-së pasi që diskriminohen prodhuesit tjerë si dhe ofertuesit të cilët planifikojnë që të marrin pjesë në këtë tender. Prandaj, kërkesa që OE të paraqesin listën e pajisjeve, mjeteve, makinave teknike të lartcekura duhet të hiqen pasi që sikur kemi cekur se edhe kjo kërkesë e favorizon vetëm ndonjë O.E. të caktuar dhe diskriminon prodhuesit apo O.E. tjerë.

Në nenin 7. OE të ofrojë katalogun e produkteve me përshkrim të detajuar. Katalog i nënshkruar dhe vulosur në të cilin duhet specifikuar të gjitha karakteristikat për të gjitha produktet, për produktet të cilat nuk i prodhon ofertuesi duhet të prezantojë autorizim nga prodhuesi apo marrëveshje për furnizim me ato materiale dhe kohën e garancionit.

Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje edhe tek kjo kërkesë pasi që bie ndesh me këtë natyrë të prokurimit dhe nuk është relevante me natyrën e prokurimit sepse të gjithë artikujt janë standarde dhe konsiderojmë se për produktet të cilat janë standarde nuk na duhet katalogu sepse inventarin mund ta prodhojë do fabrikë e mobileve, por në këtë kërkesë kërkojmë që edhe kjo kërkesë të hiqet pasi që haptas shihet se ishte vënë me qëllim të vënies në lajthim të O.E. të interesuar pasi që kjo kërkesë është përgatitur për një O.B.

Në nenin 8. OE ofertues duhet të sjellë planin dinamik, të detajuar për secilin pozicion. 8. Plani dinamik i detajuar i vulosur dhe i nënshkruar.

Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje edhe tek kjo kërkesë pasi që haptas e kufizon konkurrencën ndërsa shumë qartë shihet se Autoriteti kontraktues ishte vënë në lajthitje, andaj kërkojmë që edhe kjo kërkesë në fjalë të hiqet.

Në nenin 9. OE të ofrojë deklaratë garancioni për të gjitha produktet të paktën 1 vit. OE të ofrojë deklaratë të nënshkruar dhe vulosur ku përcaktohet numri i prokurimit dhe titulli i këtij aktiviteti të prokurimit sa duhet të jetë garancioni.

Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje edhe tek kjo kërkesë, pra kërkesa është e paspecifikuar dhe e paqartë me qëllim të vënies në lajthim të O.E. të interesuar pasi që tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale autoriteti kontraktues ka kërkuar 1 vit garancion, por të njëjtën gjë nuk e ka kërkuar tek specifikat teknike pasi që në përshkrimin e çmimit ishte kërkuar 5 vite garancion, andaj kjo kërkesë apo ky kriter duhet të hiqet menjëherë pasi që është bërë për të vënë në lajthitje një O.E. të interesuar.

Kërkojmë nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i hiqni kriteret diskriminuese pasi që haptas po e kufizoni pjesëmarrjen e OE tjerë të interesuar për këtë projekt.

Gjithashtu edhe sasitë janë paraqitur në kundërshtim me sqarimin e KRPP-së për kontratat me njësi pasi që tek kontratat e furnizimit duhet të përcaktohet secili artikull në mënyrë që të dihet sasia e kërkuar.

Andaj, kërkojmë që në përputhje me dispozitat e LPP-së të lartëcekura të mënjanoi kriteret diskriminuese teknike të përzgjedhjes të cekura më lart të cilat janë përfshirë në njoftim për kontratë dhe në dosjen e tenderit, lidhur me aktivitetin e prokurimit në fjalë, si dhe të zgjatni afatin për dorëzimin e ofertave përndryshe jemi të detyruar që të paraqesim ankesë në OSHP dhe do t'i njoftojmë organet tjera kompetente.

Si dhe kërkojmë nga ju si Organi Shqyrtues i Prokurimit që ankesa jonë ta shqyrtojë me përpikmëri të lartë dhe ta detyrojë Autoritetin Kontraktues Komuna e Prishtinës që ta bëjë heqjen e të gjitha kriterëve pasi që janë kriterë diskriminuese dhe këto kriteret e këtij tenderi shihet qartë se i janë përgatitur Operatorit Ekonomik Wood Corporation pasi që edhe tek një projekt tjetër autoriteti kontraktues Komuna e Prishtinës ka vënë kriteret e ngjashme apo të njëjta me qëllimin e përfitimit të kundërligjshëm si dhe zhvatjen e paras publike, andaj edhe njëherë lusim Organin Shqyrtues të Prokurimit të veprojë në bazë të dispozitave dhe ta vlerësojë ankesën tonë si të bazuar, më poshtë gjeni edhe dëshmitë në anë siç janë dhe si i kanë marrë kriteret nga tenderët e mëparshëm me anë të përfitimit të kundërligjshëm dhe zhvatjen e paras publike bashkëngjitur gjeni dëshmitë në bazë të fotografive. Autoriteti Kontraktues pas paraqitjes së kërkesës për heqjen e kriterëve diskriminuese e ka pezulluar aktivitetin e prokurimit si dhe autoriteti kontraktues pas pranimit të kërkesës tonë për heqjen e kriterëve diskriminuese nuk e ka shqyrtuar brenda afatit (3) ditë, si dhe ka marrë vendimin për refuzim të kërkesës duke vepruar në kundërshtim me të gjitha nenet dhe dispozitat e prokurimit publik duke i dëmtuar bizneset me faktin se AK është vënë në lajthitje nga OE WOOD Corporation me qëllimin e përfitimit të kundërligjshëm si dhe zhvatjen e paras publike.

Andaj, kërkojmë që ju si Organi Shqyrtues i Prokurimit që në përputhje me dispozitat e LPP-së së lartëcekura ta detyroni Autoritetin Kontraktues që t'i mënjanojë kriteret diskriminuese teknike të përzgjedhjes të cekura më lart të cilat janë përfshirë në njoftim për kontratë dhe në dosjen e tenderit, lidhur me aktivitetin e prokurimit në fjalë, si dhe ta zgjasin afatin për dorëzimin, si dhe do t'i njoftojmë organet tjera përkatëse dhe ato evropiane.

Gjithashtu edhe sasitë janë paraqitur në kundërshtim me sqarimin e KRPP-së për kontratat me njësi pasi që tek kontratat e furnizimit duhet të përcaktohet secili artikull në mënyrë që të dihet sasia e kërkuar.

Lusim edhe një herë që Organi Shqyrtues i Prokurimit të marrë për bazë të gjitha pretendimet tona dhe të analizojë të gjitha faktet dhe dëshmitë që i kemi paraqitur në ankesë dhe të marrë masa ndaj AK Komuna e Prishtinës pasi që të njëjtit po veprojnë në kundërshtim me ligjet e prokurimit publik.

Duke u bazuar në faktet dhe provat e lartëcekura kërkojmë nga ju si AK që ta aprovoni ankesën tonë si të bazuar dhe të bëni ndryshimet të cilat ishin nxjerrë në vendim për t'u hequr. Në rast se ju si Autoritet Kontraktues Komuna e Prishtinës nuk i hiqni kriteret diskriminuese të cekura më lart ne jemi të obliguar që të paraqesim ankesë në OSHP dhe në organet tjera përkatëse.

Edhe pas paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim AK nuk ka marrë fare për bazë pretendimet tona dhe ka lëshuar një vendim blanco duke mos cekur fare pse janë refuzuar pretendimet tona, andaj edhe pas verifikimit të vendimit të lëshuar nga AK Komuna e Prishtinës kemi parë shkelje të tjera që urgentisht kjo procedurë duhet të hiqen kriteret diskriminuese dhe procedura të ritenderohet, andaj po i bashkëngjisim disa fakte dhe shkelje të konstatuara me ligjin e prokurimit publik të cilat cilësohen si shkelje të rënda ligjore:

Moszbatimi i vendimit të formës së prerë të OSHP-së nr. 0770/2025, në kundërshtim me nenin 131.3 të LPP-së.

Përfshirja e kriterëve diskriminuese dhe të panevojshme si: kërkesa për inxhinier emergjencash, punëtorë të trajnuar për zjarrfikje dhe certifikata ISO që nuk kanë lidhje me natyrën e kontratës së furnizimit me mobilie.

Mosrespektimi i parimeve të konkurrencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomik (neni 7 dhe neni 10 i LPP-së).

Moszgatja e afatit të ofertimit pas ndryshimeve në dokumentet e tenderit, në kundërshtim me nenin 53 të LPP-së.

Mosraportimi tek OSHP brenda afatit 10-ditor për zbatimin e vendimit, në kundërshtim me nenin 131.4 të LPP-së.

Kërkesa për dokumente të noterizuara, në kundërshtim me nenin 26.16 të Rregullores për Prokurim Publ??.

Kërkesa për dëshmi doganore dhe fotografi të mjeteve transportuese, e panevojshme dhe kufizuese për konkurrencën.

Mos përputhja në kërkesën e garancionit midis specifikave teknike dhe dosjes së tenderit (1 vit vs 5 vite), që bie ndesh me nenin 27 të LPP-së për qartësi dhe transparencë.

Kërkesa për katalogë dhe autorizime nga prodhuesi për artikuj standarde, që nuk janë të domosdoshme për kontratat e furnizimit.

Si edhe njëherë ju lusim dhe kërkojmë nga ju si Organi Shqyrtues i Prokurimit që ankesa jonë ta shqyrtojë me përpikmëri të lartë dhe ta detyrojë Autoritetin Kontraktues Komuna e Prishtinës që t'i bëjë heqjen e të gjitha kriterëve pasi që janë kriterë diskriminuesë dhe këto kriteret e këtij tenderi shihet qartë se i janë përgatitur Operatorit Ekonomik Wood Corporation pasi që edhe tek një projekt tjetër autoriteti kontraktues Komuna e Prishtinës ka vënë kriteret e ngjashme apo të njëjta me qëllimin e përfitimit të kundërligjshëm pasi siç dihet tani më se zyrtari i prokurimit Visar Shehu vazhdimisht publikon tender me kriterë të përgatitura për OE Wood Corporation duke vepruar në kundërshtim me ligjin, si dhe po bëjnë zhvatjen e paras publike dhe po krijojnë korrupsion të qartë pasi që kemi parë se edhe OE tjerë vazhdimisht paraqesin kërkesa për heqjen e kriterëve diskriminuesë dhe ankesa, mirëpo ky zyrtar i prokurimit vepron sipas qejfit dhe interesit të tij dhe jo sipas ligjit për Prokurim Publik. Në gjatë hulumtimit për këtë zyrtar të prokurimit dhe OE të lartëcekura kemi hasur se edhe më parë OSHP dhe eksperti kanë konstatuar shkelje, mirëpo ai ka vepruar sipas qejfit dhe interesit të tij dhe jo sipas ligjit. Po ju bashkëngjisim një link ku shihet qartë se zyrtari i prokurimit publik Visar Shehu është vënë në lajthitje nga OE Wood Corporation dhe se këta po dëmtojnë rëndë buxhetin e Komunës së Prishtinës dhe zhvasin paratë e taksapaguesve të Komunës së Prishtinës. Bashkëngjitur gjeni linkun:

<https://demokracia.com/tenderi-600-mije-euro-per-furnizim-me-inventare-eksperti-i-oshp-se-gien-se-komuna-e-prishtines-vendosi-kriter-te-kunderligjshme-qe-favorizojne-kompani/>

Andaj edhe njëherë lusim Organin Shqyrtues të Prokurimit të veprojë në bazë të dispozitave dhe ta vlerësojë ankesën tonë si të bazuar dhe të marrë sa më parë masa ndaj zyrtarit të prokurimit publik dhe OE-së së lartëcekur.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit duhet sqaruar se me datë 17.10.2025 OSHP ka publikuar vendimin me nr. 2025/0770, përmes të cilit ka miratuar pjesërisht ankesën e parashtruesit lidhur me kërkesat e DT. Me datë 20.10.2025 autoriteti kontraktues ka publikuar formularin për korrigjimin e kërkesave të DT, ashtu që ka adresuar të gjitha të gjeturat dhe konstatimet sipas vendimit të OSHP duke eliminuar apo ndryshuar/plotësuar të gjitha kërkesat që kanë mundur të jenë diskriminuese apo favorizuese. Kërkesat e mbetura në dosjen e tenderit jo vetëm që janë në përputhje të plotë me vendimin e lartcekur të OSHP, por si të tilla janë kërkesa absolutisht të domosdoshme dhe në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacionin sekondar në fuqi.

Përmes nenit 10, paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuuese, ndër të tjera, ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Përmes nenit 11, paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit, ndër të tjera, në bashkëpunim me njësinë kërkuuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga

njësia kërkuese.

Pretendimet ankimore të parashtruesit janë shqyrtuar secila një nga një dhe me këtë rast është gjetur se këto pretendime jo vetëm që janë të pabazuara në kuptim të kësaj kërkesë për rishqyrtim, por si të tilla tanimë ato janë trajtuar nga OSHP (pra bëhet fjalë për çështje të gjykuara) si dhe janë adresuar nga AK përmes formularit për korrigjimin e DT.

Nga sa u tha më sipër, është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 28.10.2025 ka autorizuar ekspertin/teknik për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr.1048/2025, ndërsa me datë 03.10.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues/teknik me nr. 2025/1048 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale, Autoriteti kontraktues nuk pajtohet rreth raportit të ekspertit shqyrtues ndërsa OE nuk është përgjegjës rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtruesat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritues lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtruesat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE SRAHEP SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/1048 ka vlerësuar si në vijim:

Përgjigje në Pretendimet Ankimore të aktivitetit me të dhënat numër OSHP: 2025/0692

Eksperti shqyrtues, pas verifikimit një nga një të dokumenteve lidhur me pretendimet ankimore të palës ankuese, pretendime të cilat janë ripërseritur në këtë aktivitet e të cilat kanë atakuar kriteret në FDT të dosjes së tenderit, duke i verifikuar e krahasuar, kërkesat e dosjes së tenderit, pretendimet e palës ankuese, vendimet e OSHP-së si dhe të gjeturat e PSH në vendimin numër 2025/0770.

Bazuar në Ligjin për Prokurimin Publik (LPP), si dhe aktet ligjore sekondare të Rregullores për Prokurimin Publik (versioni i konsoliduar), dhe në dokumentacionin e dosjes së tenderit, me theks të veçantë në kërkesat në FDT, konstaton sa vijon:

Kërkesat e dojes së tenderit:

Pretendimet Akimore për menaxherin e projektit e rëndituar numër 2, Kërkesat mbi mundësin teknike dhe/ose profesionale:

Eksperti shqyrtues, mbështetur edhe në mendimin dhën për të njëjtin pretendim ankimor në ekspetizën numër **2025/0770** ku është thënë se: konstaton se kërkesa në FDT. OE duhet të caktoj një projekt menaxher i diplomuar në (dizajn të enterierit) duke dëshmuar edhe përvojën e punës pas diplomimit 5 (pesë) vite. Natyra e projektit në këtë aktivitet në parimin ligjorë të kërkesës në dosjen e tenderut, më saktësisht (ANEKS 1) duke referar në paramasën për dhënjën e çmimeve ku janë të listuara të gjitha kërkesat e këtij projekti, por në disa nga pozicionet mundësojnë rolin vital të inxhinierit (dizajn të enterierit) në kualifikimet e cituar më lartë dhe si kërkesë në dosjen e tenderit është në harmoni me këtë projekt.

Arsyetim

Roli kryesor i inxhinierit të interierit në këtë rast:

Përputhja me projektin

- Analizon hapësirat e destinuara për inventar dhe siguron që produktet e ofruara (karrige, tavolina, kolltuqe etj.) janë të përshtatshme për dimensionet, funksionin dhe komoditetin e përdoruesve.
- Jep zgjidhje teknike për shfrytëzimin racional të hapësirës (ergonomia e punës, distancat, lartësitë, qarkullimi i lirë).

Specifikimet teknike dhe cilësia

- Kontrollon që inventari i propozuar përputhet me specifikimet e kërkuara në dosjen e tenderit (materiali, dimensionet, ngjyrat, rezistenca, garancia etj.).
- Vlerëson cilësinë e materialeve dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të tyre.

Estetika dhe harmonia vizuale

- Siguron që inventari të krijojë një ambient të përshtatshëm pune apo pritjeje, duke respektuar identitetin vizual të institucionit.
- Jep këshilla për kombinimin e ngjyrave, formave dhe dizajnit të mobiljeve që të ketë harmoni me ambientin ekzistues.

Standardet dhe normat profesionale

- Kujdeset që inventari të përmbushë standardet ergonomike, të sigurisë dhe të shëndetit në punë (p.sh. karrige pune sipas standardeve).
- Konsideron aksesueshmërinë për persona me aftësi të kufizuara, kur kërkohet.

Mbikëqyrja e zbatimit

- Ndihmon gjatë fazës së pranimi të mallit, duke verifikuar nëse produktet e dorëzuara përputhen me specifikimet teknike të ofertës dhe kërkesat e tenderit.

- Jep opinion profesional nëse inventari i sjellë është i njëjtë me atë të ofertuar.

Andaj, bazuar në dispozitat ligjore, të gjeturat e PSH në Vendimin e OSHP-së numër 2025/0770, natyrën e projektit, kriteret e dosjes së tenderit, pretendimi ankimore është i pabazuarë.

Kërkesat e dojes së tenderit:

Pretendimet Akimore për kërkesa e rënditura numër 3 dhe 4. Kërkesat mbi mundësin teknike dhe/ose profesionale:

Eksperti shqyrtues konstaton se, sipas kërkesave në FDT, operatori ekonomik duhet të ketë një inxhinier të diplomuar të emergjencave ose master, me së paku pesë (5) vite përvojë pune pas diplomimit, i cili duhet të jetë i certifikuar si ekspert për siguri në punë dhe mbrojtje nga zjarri. Ndër kërkesat e tjera, operatori ekonomik duhet të ketë gjithsej pesëmbëdhjetë (15) punëtorë, prej të cilëve pesë (5) të jenë të certifikuar për mbrojtje nga zjarri.

Stafi i kërkuar, në kuptimin e projektit, i cili do të kryente punë teknike si bartje, montim apo edhe prodhim, do të konsiderohej i pranueshëm edhe nëse do të kërkohej vetëm lista e punëtorëve, si dhe operatorëve ekonomikë të interesuar për këtë projekt do t'u mundësohej që të paraqesin raportin e vlerësimit të rrezikut të kompanisë, të lëshuar nga organet kompetente.

Arsyetim Ligjorë

Sepse: LIGJI NR. 04/L-161 PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË, Neni 9 paragrafi 4.

Shërbimet për mbrojtjen dhe parandalimin, paragrafi 4. Punëdhënësi, në mungesë të personelit të kualifikuar për të udhëhequr me sigurinë dhe shëndetin në punë, brenda subjektit të tij do të angazhojë persona ose institucione për shërbime profesionale të jashtme.

Neni 10

Të punësuarit e ngarkuar për siguri dhe shëndet në punë

1. Punëdhënësi i cili punëson deri në pesëdhjetë (50) të punësuar, nëse është i aftë/kompetent, mund të marrë vetë përgjegjësinë për zbatimin e masave të përcaktuara në paragrafin 1. të nenit 9 të këtij ligji, me kusht që t'i plotësojë kushtet dhe kriteret sipas paragrafit 5. të nenit 9 të këtij ligji.

2. Punëdhënësi i cili punëson mbi pesëdhjetë (50) e më pak se dyqindpesëdhjetë (250) të punësuar, është i detyruar të caktojë një ekspertë, për kryerjen e detyrave nga siguria dhe shëndeti në punë.

3. Punëdhënësi i cili punëson më shumë se dyqind e pesëdhjetë (250) të punësuar duhet të angazhojë një (1) ose më shumë ekspertë për kryerjen e detyrave nga siguria dhe shëndeti në punë.

Bazuar në të dhënat dhe argumentet e paraqitura, eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi ankimor është i bazuar.

Kërkesat e dojes së tenderit:

Pretendimet Akimor për, Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale renditur numër 5, në FDT:

Eksperti shqyrtues konstaton se, kërkesa në FDT- ISO 10002:2018

Qëllimin e këtij standarti: ISO 10002:2018 është standard ndërkombëtar që ofron udhëzime për trajtimin efektiv të ankesave në organizata, me synim përmirësimin e kënaqësisë së klientit dhe forcimin e besueshmërisë së shërbimeve dhe produkteve.

Fusha e veprimit: Ky standard jep udhëzime për planifikimin, projektimin, zhvillimin, funksionimin, ruajtjen dhe përmirësimin e procesit për trajtimin e ankesave në lidhje me produktet dhe shërbimet e ofruara nga një organizatë. Ai është i zbatueshëm për organizata të çdo madhësie dhe sektori.

Përfimet kryesore: Përmirësimi i kënaqësisë së klientit përmes adresimit të ankesave në mënyrë të drejtë dhe të shpejtë.

- Forcimi i reputacionit dhe besueshmërisë së organizatës.
- Identifikimi i dobësive në produkte dhe shërbime dhe ndërmarrja e masave korrigjuese.
- Nxitja e përmirësimit të vazhdueshëm në proceset e brendshme.

Përfundimi: ISO 10002:2018 është një mjet thelbësor për organizatat që synojnë të menaxhojnë ankesat me efikasitet dhe të përmirësojnë marrëdhëniet me klientët përmes një qasjeje të strukturuar dhe transparente.

Bazuar në të dhënat dhe argumentet e paraqitura, eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi ankimor është i bazuar.

Eksperti shqyrtues konstaton se, kërkesa në FDT- TC 136:

Çfarë është ISO TC 136: është Komiteti Teknik i Organizatës Ndërkombëtare për Standardizim (ISO) që merret me standardizimin e mobiljeve. Ky komitet përgatit standarde që sigurojnë cilësinë, sigurinë, ergonominë dhe qëndrueshmërinë e mobiljeve për përdorim në shtëpi, zyra dhe ambiente të tjera.

- Fusha e Veprimtarisë: Komiteti Teknik TC 136 mbulon të gjitha aspektet që lidhen me:
- Specifikimet teknike për prodhimin e mobiljeve;
- Testimin e sigurisë, qëndrueshmërisë dhe ergonomisë;
- Kërkesat për materialet dhe proceset e prodhimit;
- Harmonizimin e standardeve ndërkombëtare për mobilje.

Rëndësia: Standardet e zhvilluara nga ISO TC 136 ndihmojnë:

- Në sigurimin e cilësisë dhe jetëgjatësisë së produkteve;
- Në mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë së përdoruesve;

- Në përputhjen me rregulloret dhe kërkesat ligjore ndërkombëtare;
- Në lehtësimin e tregtisë globale dhe certifikimit të produkteve;

Përfundim: ISO TC 136 luan një rol kyç në zhvillimin e standardeve për mobilje, duke siguruar që produktet të jenë të sigurt, cilësore dhe në përputhje me kërkesat globale.

Bazuar në të dhënat dhe argumentet e paraqitura, eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi ankimor është i pabazuar

Eksperti shqyrtues konstaton se, kërkesa në FDT- ISO 19682:2023

Qellimi: ISO 19682:2023-është një standard ndërkombëtar i publikuar në korrik 2023 nga Organizata Ndërkombëtare për Standardizim (ISO). Ai specifikon metoda testimi për qëndrueshmërinë, forcën dhe qëndrueshmërinë e strukturës së çdo lloji tavoline dhe tryeze, pa marrë parasysh përdorimin, materialin, mënyrën e përbërjes apo procesin e prodhimit

Fusha e zbatuar: Metodatat e testimit për stabilitet, forcë dhe qëndrueshmëri të strukturës së tavolinave dhe tryezave.

Çdo lloj tavoline mbulohet - jo vetëm mobilje zyre, por edhe tavolina shtëpie, industriale, etj. Çdo material, dizajn apo metodë prodhimi, e përfshirë.

Siguron besueshmëri të testimeve - laboratorët e prodhuesit mund të verifikojnë sipas të njëjtave procedura.

Ndihmon për përmirësime në produkt - produktet mund të dizajnohen dhe prodhohen më të sigurt dhe të qëndrueshme.

Harmonizim ndërkombëtar - përputhje me standarde globale (veçanërisht me ISO/TC 136).

Siguria e konsumatorit - tavolinat e testuara sipas këtij standardi përmbushin kritere më të larta sigurie dhe jetëgjatësie.

Bazuar në të dhënat dhe argumentet e paraqitura, eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi ankimor është i pabazuar

Eksperti shqyrtues konstaton se, kërkesa në FDT- ISO 10204

Fusha e Zbatimit të ISO 10204: Standardi ISO 10204 përcakton kërkesat për certifikatat e inspektimit të materialeve metalike dhe produkteve industriale që kërkojnë prova kimike ose fizike të përbërjes së materialeve. Ky standard nuk përfshin kërkesa për dizajnin, prodhimin, qëndrueshmërinë apo sigurinë e mobiljeve.

Bazuar në të dhënat dhe argumentet e paraqitura, eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar.

Eksperti shqyrtues konstaton se, kërkesa në FDT- EN 1335-1

EN 1335-1 është një standard evropian i cili i përket serisë EN 1335 dhe lidhet me karriget e zyrës (office furniture). Ky standard përcakton kërkesat dimensionale dhe ergonomike për karriget që përdoren në ambiente të punës.

EN 1335-1 - Siguron që karriget e zyrës janë ergonomike dhe të përshtatshme për shumicën e përdoruesve

- Shërben si referencë ligjore për furnizime publike ose tendera ku kërkohen karrige standarde europiane.

Bazuar në të dhënat dhe argumentet e paraqitura, eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi ankimor është i pabazuar.

Eksperti shqyrtues konstaton se, kërkesa në FDT- EN 10901 2009+A1 2011

Fusha e Zbatimit të EN 1090-1

Standardi EN 1090-1:2009+A1:2011 përcakton kërkesat për prodhimin dhe certifikimin e strukturave metalike (çelik dhe alumini) dhe përputhshmërinë e tyre me direktivat europiane (CE marking). Ky standard nuk lidhet me produktet që janë objekt i tenderit, si TV, PC, pajisje sanitare, llampa apo mobilje, tavolina, dhe karrike.

Bazuar në të dhënat dhe argumentet e paraqitura, eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi ankimor është i bazuar.

Eksperti shqyrtues konstaton se, kërkesa në FDT- TS EN 10204:2007

TS EN 10204:2007 është një standard europian që përcakton llojin e dokumentacionit të inspektimit për materialet metalike. Ai përdoret për të siguruar që materiali (p.sh. çelik inox, çelik I galvanizuar etj.) i përdorur në një produkt përputhet me kërkesat teknike.

Bazuar në të dhënat dhe argumentet e paraqitura, eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi ankimor është i bazuar.

Eksperti shqyrtues konstaton se, kërkesa në FDT- TS ISO 21524 2021

ISO 21524:2021 është një standard ndërkombëtar që përcakton kërkesat për projektimin, testimin dhe klasifikimin e perdeve aktive të zjarrit të ndërtuara për të ofruar rezistencë ndaj zjarrit dhe tymit.

Bazuar në të dhënat dhe argumentet e paraqitura, eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi ankimor është i pabazuar.

Kërkesat e dojes së tenderit:

Pretendimet Akimore, lidhur me Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale renditur numër 6 në FDT:

Eksperti shqyrtues, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe të dhënave të paraqitura, konstaton se kërkesa e Autoriteti Kontraktues në FDT të dosjes së tenderit është në pajtueshëri me aktet ligjore të LPP-së. Kërkesa përmbush kriteret e nevojshme në këtë aktivitet dhe është në përputhje me dispozitat dhe udhëzimet përkatëse për këtë arsye pretendimi i OE është i pa bazuar.

Kërkesat e dosjes së tenderit:

Pretendimet Akimore, lidhur me Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale renditur numër 7,8,9 në FDT:

Përgjigjet ekspertit shqyrtues lidhu me pretendimet akimore 7, 8, 9 – kërkesa në FDT të dosjes së tenderit lidhur me katalogun e produkteve si kërkesë e autoritetit kontraktues ka mundësuar që operatorët ekonomik të prezantojnë katalog i nënshkruar dhe vulosur në të cilin duhet specifikuar të gjitha karakteristikat për të gjitha produktet, të cilat nuk i prodhon ofertuesi duhet të prezantojë autorizim nga prodhuesi apo marrëveshje për furnizim me ato materiale dhe kohën e garancionit. Autoriteti kontraktues nga natyra e projektit ka kërkuar kriter i cili në brendësinë e saj është kërkesë profesionale e cila pasqyron dhe konkretizon listatën e furnizimi si nga prodhuesi po ashtu edhe nese të njëjtat importohen katalogu dhe autorizimi nga prodhuesi janë të pranishme në procedurat e furnizimit. Andaj, pretendimi ankimor është i pabazuar.

Prendimi 8-Plani dinamik i detajuar, i vulosur dhe i nënshkruar. Kërkesa për paraqitjen e planit dinamik është në përputhje të plotë me aktet ligjore primare dhe sekondare që rregullojnë Ligjin për Prokurimin Publik (LPP), pasi që ky plan pasqyron kohën e fillimit dhe përfundimit të furnizimeve. Si e tillë, kjo kërkesë nuk përmban elemente diskriminuese dhe është lehtësisht e realizueshme nga operatorët ekonomikë si material profesional. Andaj, pretendimi ankimor në këtë pretendim vlerësohet si i pabazuar.

Kërkesa lidhur me deklaratën për garancionet dhe periudhën është në harmoni me aktet ligjore primare dhe sekondare të LPP-së. Andaj, pretendimi ankimor është i pabazuar.

-Konstatimi dhe perfundimet e Panelit Shqyrtues-

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i angazhuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilave dispozita kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rasti, ku ka analizuar pretendimet ankimore të paraqitura nga OE ankues. Pas analizimit të raportit të ekspertit shqyrtues, PSH ka kërkuar tek eksperti duke i parashtruar pyetje 1.Pretendimet e ankuesit a janë ndryshme nga ato të ankesës me nr 2025/0770 për çka keni qenë i angazhuar, ne raste se po cilat? 2.A e keni analizur vendimin e PSH me nr 2025/0770 që ka lidhje me këtë procedurë? Për çfarë është përmend Vendimi në raportin e ekspertit shqyrtues OSHP: 2025/0692 ku procedura është tjetër, ndryshon edhe aktiviteti (ka qenë Sistemi i Arkivës Digjitale dhe Menaxhimi i Dokumenteve) ?, dhe në përgjigjen e marur për panelin konsiderohen jo profesionale duke mos ofruar asnjë përgjigje

konkrete.

Kjo procedur është trajtuar me vendim OSHP;2025/0770 i dt: 17/10/2025, ku objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, andaj ky rast konsiderohet si çështje e gjykuar “Res Judicata”. Sikurse parashihet në nenin 16, pika 2 të Rregullores Nr.01/2020, e Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit. Mirpo PSH konsideron se OE ankues vetëm sa e ka prolonguar procedurën.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - SRAHEP SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: